



**Bashkia Rrogozhine**

**NJËSIA E PROKURIMIT**

**PROCES VERBAL**

**PËR**

**ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMINE SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**Tipi i kontratës – PUNË**

**OBJEKTI I PROKURIMIT:** *“Rikonstrukcion te rrjetit elektrik per rritjen e fuqise energjitiqe prane ‘Arena Egnatia’, Bashkia Rrogozhine”*

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT(CPV): 31100000-7  
(motore elektrik, gjeneratore, transformatore), 45112000-5(punime germimi)**

- **Ref: 29156-11-13-2024**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 10.000.000 (DHJETE MILION) lekë pa tvsh.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Kavajë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë::

### **KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

c. *Formulari i ofertës sipas shtojcës 1.*

d. *Lista e çmimeve sipas zërave të preventivit, sipas Shtojcës 2*

**Argumentimi:** Njesia e Prokurimit për pikat a. dhe b. bazohet në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, seksioni III, neni 39, pika 7, gërma “ç”.



Kërkesa për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 83, pika 1 si dhe nëVKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 30, pika 1.Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 82 si dhe nëVKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 26.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

### **2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit (shtojca 7).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, tëLigjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, nenin39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

Operatori ekonomik duhet të ketë burime financiare të nevojshme për realizimin e objektit të prokurimit. Në këtë kontekst, operatorët ekonomik duhet të tregojnë se i përmbushin kushtet e mëposhtme:

2.2.1 Operatori ekonomik duhet të ketë burime financiare të nevojshme për realizimin e objektit të prokurimit. Në këtë kontekst, operatorët ekonomik duhet të tregojnë se i përmbushin kushtet e mëposhtme: Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Kopje të çertifikuar të bilanceve të 2 (dy) viteve të fundit financiare (2022,2023),ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e eriu dhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **vlera e fondit limit qe prokurohet**, të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar

*Shënim: Akt ekspertiza e ekspertit kontabël të autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor , organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar, i ndryshuar”.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë referuar nenin 55 pika 4/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik. Kërkesa për paraqitjen e xhiros së viteve financiare 2018, 2019, 2020, nuk i kufizon operatorët ekonomik vetëm në vite qe mund te jenë jo të sukseshme financiarish, por me kohështirje tre vjecare. Vlera e xhiros së kërkuar në masë jo më e vogël se se vlera e fondit limit shkon përshat me vlerën e fondit limit dhe afatin e realizimit të kontratës. Konkretish niveli i aktivitetit të shoqërisë është në masë financiare ekuivalent me vlerën e mundshme të kontratës objekt prokurimi.



**2.2.2** Kopje të deklaramit të xhiros vjetore për 3 (tre) vitet e fundit financiare (2022, 2023 dhe 2024 per aq sa i takon) të lëshuar nga autoritetet përkatëse, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës objekt prokurimi.** *(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.)*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në nenin 43 pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe nenit 41, pika “c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”

**2.2.3** Vërtetim të shlyerjes së taksave e tarifave vendore të parashkikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2022 dhe 2023 dhe 2024 per sa i takon dhe sipas përcaktimeve të Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB-së. ( Ky kriter do të konsiderohet I përmbushur nëpërmjet paraqitjes së Formularit të Vetëdeklarimit sipas shtocës 8 në DST).

*(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazes së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, dokumentet perkatëse vertetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB-së. Për të përmbushur kërkesën e mësipërme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues i përcaktuar mesipër duhet të paraqitet pranë Autoritetit Kontraktor para lidhjes së marrëveshjes kuadër*

## **2.3 Kapaciteti Teknik:**

**Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:**

### **2.3.1 Përvoja e sukseshme në realizimin e të paktën:**

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më madhe se **30% e vlerës së përlllogaritur** të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë 5 (pesë) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose



- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është **jo më e madhe se vlera limit** e kontratës që prokurohet.

### **Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.**

***Pika 2.3.1 /a plotësohet nga anëtari , i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomik, anëtar të një bashkimi, kanë të njejten përqindje pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.***

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në dokumentat e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e sukseshme të punëve, *të shoqëruara me formulat vlerësimi sipas shtojcës 9.*
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, OE duhet të paraqesë vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet referuar nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55 pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik.

**2.3.2** Operatori Ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga *Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë*, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

- N.P – 1A Punime gërmimi në tokë,



-N.P – 4A Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale,

-N.P – 11A Ndërtime për nënstacionet, kabinat e transformatorëve, linja e tensionit të lartë e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.

### **Punime speciale ndërtimi:**

- N.S – 8A Ndërtime parafabrikate betona arme, struktura metalike dhe druri,
- N.S – 14A Impinate të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV,
- N.S – 18A Punime topogjeodezike.

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licëbsave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i orgjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (ose në Ministrinë kompetente të kohës), Republika e Shqipërisë. ( Licenca duhet të përmbajë të gjitha kriteret e përcaktuara në VKM-në nr.42, datë 16.01.2008 ”Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit, dhe disiplinimit të subjekteve juridikë, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Mosparaqitja e licencës sipas formës së kërkuar në këtë VKM, është kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendimit të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

**NP 1 – A** Punime gjurmimi në tokë “Gjurmim dhe me eskavator”. Konsiderohen gjurmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gjurmohet ose sistemohet vegetale, argjilore, ranore, zhavorishte ose shkëmbore. Sipas preventivit bashkangjitur. Niveli i klasifikimit është A. Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, është me e vogël se 20 milion leke

**NP 4 – A** (Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale). Përfshin në mënyrë të thjeshtuar rrugët, pavarësisht nga shkalla e tyre e rëndësisë, autostradat, superstradat përfshirë ndërhyrjet në pika të veçanta, tunelet, devijimet në nivele dhe në lartësi, parkimet, punime të mureve mbajtëse, hekurudha, metro, hekurudhë me kavo, tramvai, pista aeroportuale, sheshet e helikopterëve, sheshet të realizuara me materiale të veçanta, natyrore dhe artificiale, urat, si dhe komplekse karakteristikash teknike, në hekur, betonarme të thjeshtë dhe të parandëruar, parafabrikat ose të prodhuar në objekt. Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturim i ndërhyrjeve në rrjetin rrugor të nevojshëm për të ndjerë paqëndrueshmërinë mbi “goma”, “hekur”, “zona”, kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo veprë lidhëse, plotësuese ose pajisje edhe e tipit të veçantë, të linjës hekurudhore. Sipas preventivit bashkangjitur. Niveli i klasifikimit është A.

**NP 11 – A** (Ndërtime për nënstacionet, kabinat e transformatorëve, linja e tensionit të lartë e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë). Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në



rrjet që janë të nevojshëm për shpërndarjen e T/N dhe tensionit të mesëm dhe për transformimin dhe shpërndarjen e tensionit të ulët deri te përdoruesit e energjisë elektrike, të kompletuar me punimet e muraturës, plotësuese ose ndihmëse, të veçanta ose të rrjetit. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar centrale dhe kabina transformacioni, shtyllat metalike të nevojshme për transportin dhe shpërndarjen e çfarëdo lloj tensioni, furnizimin dhe vendosjen në vepër të linjave elektrike për çfarëdo numër fazash elektrike, ajrore ose tokësore. Niveli i klasifikimit është A.

**N.S – 8 – A** (Ndërtime parafabrikate betona arme, struktura metalike dhe druri). Përfshin prodhimin në rrugë industriale dhe montimin në vepër të strukturave parafabrikate prej betoni të armuar, normal dhe të paranderur. Prodhimin në kantier dhe montimin në vepër të strukturave prej çeliku ose të fasadave të përbëra nga telajo metalike dhe elemente modulare prej xhami ose materiali tjetër. Prodhimin në rrugë industriale dhe montimin në vend të strukturave të përbëra nga elementë të drejtë të trajtuar përpara. Niveli i klasifikimit është A.

**N.S – 14 – A** (Impinate të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV). Konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave elektrike, telefonike, radiotelefoni e TV, si edhe të linjave të transmetimit të ngjashme me to, të kompletuar me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për t'u realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme. Niveli i klasifikimit është A.

**N.S -18 -A** ( punime topogjeodezike) Konsiderohet zbatimi i rlevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh. Niveli i klasifikimit është A.

**2.3.3** Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të përfshirë në licencën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për periushën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave , drejtuesit teknik duhet të jenë të punësuar sipas kriterëve të VKM-së Nr.42, datë 16.01.2008, i ndryshuar. Njëri prej drejtuesve të teknik duhet të jetë i pajisur me Çertifikatë për auditues energjitik në ndërtesa, lëshuar nga Agjencia për Eficencën e Energjisë, konkretisht:

- |   |         |
|---|---------|
| a) Inxhinier ndërtimi                       | 1 (një) |
| b) Inxhinier Elektrik                       | 1 (një) |
| c) Inxhinier Topograf, gjeodet, markshajder | 1 (një) |

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetdeklarimit sipas shtojës 8. Operatori fitues përpara lidhjes së kontratës duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

Për secilin anëtar të stafit Teknik të mësipërm duhet të paraqesë:

- Kontratë pune e vlefshme;
- Diplomë.



Operatori ekonomikë duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë **Drejtuesin Teknik** të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryen punimet në objekt, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Kontratë pune e vlefshme;
- b) Diplomë.

*( Në rastin e Bashkimit të Operatorëve Ekonomik secili Operator duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryen punimet në objekt në varësi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë përsipër sipas përqindjes së bashkëpunimit).*

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetdeklarimit sipas shtojës 8. Operatori fitues përpara lidhjes së kontratës duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kontratë pune e vlefshme , diplome  
(Drejtuesit Teknik të jenë të siguruar sipas legjislacionit në fuqi.)

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, projektin, relacionet dhe raportet teknike, specifikimet dhe zërat e punimeve. . Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht gjithashtu edhe me kërkesat e përcaktuara në pikën **2.4.1** të kriteve teknike. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të ndërtim, elektrik dhe hidroteknik etj është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve.

**2.3.4** Operatori Ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar / të kualifikuar**, si më poshtë:

Teknik Ndërtimi	1 (një)
Elektracistë të certifikuar nga IQT ( Inspektoriati Qendror Teknik) apo nga organet e pavarura të njohura, të jenë të pajisur me kategorinë IV elektrike	4 (katër)
Elektracistë të certifikuar nga IQT (Inspektoriati Qendror Teknik) apo nga organe të pavarura të njohura, të jenë të pajisur me	2 (dy)



kategorinë e III elektrike	
Saldator dhe prerës të metaleve	1 (një)
Shofer	2 (dy)
Punëtor ndërtimi të thjeshtë	5( pesë)

#### **Punonjës Manovrator:**

Eskavatorist	1 (një)
Automakinist	1(një)

Për këta punonjës, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Kontratë individuale pune,
- Një dokument (diplomë profesionale/certifikatë) që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licensuara sipas Ligjit Nr.15/2017 ” Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” ose ekuivalente.
- Certifikatë të sigurimit teknik e lëshuar nga shoqëri të akredituara nga DPA ose nga organizmat ekuivalente ndërkombëtare akredituese të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Për punonjësit shofer, OE duhet të paraqesë:

- Kontratë individuale pune të vlefshme, leje drejtimi, certifikatë e aftësisë profesionale / patentë manovrimi nga DPSHTRR. (Kur punonjësit manovrator / shofer janë të kontraktuar me kontratë pune respektivisht (për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë).
- Për punonjësit Manovrator duhet të jenë të specializuar për drejtimin e mjeteve të rënda dhe për këtë duhet të paraqesin dëshmi nga Drejtoria Shërbimit të Transportit Rrugor. Kërkesa për dëshmitë e manovratorëve bazohet në urdhrin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 200, datë 16.05.2019 ”Për miratimin e rregullores ”Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe për dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke , si dhe disiplinimi i përdorimit të makineri të ndërtimit.
- (Në rastin kur punonjësit manovrator /shofer janë të kontraktuar me kontratë pune respektivisht (për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë).
- Për punonjësit e krahutb , OE duhet të paraqesë kontratën individuale të punës të vlefshme.





**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, projektin, relacionet dhe raportet teknike, specifikimet dhe zërat e punimeve. . Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht gjithashtu edhe me kërkesat e përcaktuara në pikën **2.3.3** të kritereve teknike. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të ndërtim, elektrik dhe hidroteknik etj është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve.

**2.3.5** Një punësim minimal i 20 (njetzet) personave , të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me:

- Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore për periudhën e fundit të deklaruar;
- Listëpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e fundit të deklaruar.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

**2.3.6** Operatori ekonomik, për realizimin e kontratës duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

<b>MJETET:</b>	<b>SASIA:</b>	<b>GJENDJA:</b>
Eskavator me goma	1 copë	Në pronësi ose me qera
Kamion transportues me kapacitet mbartës minimal 20 ton	1 copë	Në pronësi ose me qera
Autobetoniere	1 copë	Në pronësi ose me qera
Fadroma	1 copë	Në pronësi ose me qera
Kamioncine 3.5-5 ton	1 copë	Në pronësi ose me qera
Kenotron për kabllo , Megaometër 500V, Megaometër Meger 2500-5000 V dhe aksesoret e nevojshëm për kryerjen e matjeve dhe testeve të aparaturave elektrike)	1 copë	Në pronësi ose me qera



Terrameter për matjen e rezistencës së tokëzimit	1 copë	Në pronësi ose me qera
Autovinc me kapacitet mbartës minimal 40 ton	1 copë	Në pronësi ose me qera

*Ky kriter konsiderohet i përmbushur me vetdeklarimin sipas shtojcës nr.8 të DST-ve.*

Për mjetet me goma që shënohen në regjistra publikë , kur janë në pronësi , duhet të paraqitet dokumentacioni si më poshtë:

a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton pronësinë e mjetit:

- çertifikatën e pronësisë,
- leja e qarkullimit,
- çertifikatën e kontrollit teknik,
- siguracionin,
- leja e transportit e vlefshme dhe fotot përkatëse.

Ndërsa për mjetet e marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë e cila duhet të përfshijë objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.

- b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi , duhet të paraqitet kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore përkatëse, fotot, ndërsa për mjetet e marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm , duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë e cila duhet të përfshijë objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.
- c) Kontrata e qirasë duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të punimeve deri në përfundimin e plotë të punimeve.
- d) Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së, duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.
- e) Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të treguara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij.

Operatori ekonomik duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përshkruara nuk janë të angazhuara në procedura te tjera dhe do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontratë.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.



## 2.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikata:

- ISO 9001 :2015 ” Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë” , e vlefshme, ose ekuivalente.
- ISO 45001 : 2018 ” Sistemi i menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në vendet e punës”, e vlefshme ose ekuivalente.
- ISO 14001 :2015 ”Sistemet e menaxhimit të ambientit ” e vlefshme ose ekuivalente.
- ISO 39001 :2012 ” Sistemet e menaxhimit të sigurisë”, e vlefshme ose ekuivalente.
- ISO 50001 :2011 ” Standart për Sistemin e menaxhimit të Energjisë”, e vlefshme ose ekuivalente.

Certifikata e mësipërme duhet të jenë të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit , i akredituar nga organizma ndërkombëtare , të njohur nga Republika e Shqipërisë dhe duhet të jenë të vlefshme.

*Shënim: Në bazë të nenit 44 të VKM-së nr.285 datë 19.05.2021 , autoriteti kontraktor pranon cdo certifikatë të barasvlefshme / ekuivalente , ose një dokument që provon të njëjtin informacion. Në rast bashkim të Operatorëve Ekonomik, cdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë.*

*Argumentimi: Ne baze te nenit 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë.*

### **2.4.1** Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të jenë të pajisur me licence të lëshuar nga QKL:

”Për grumbullimin , ruajtjen dhe transportimin të mbetjeve urbane”, Kodi ii.2.B, së bashku me aktin e miratimit.

2.4.3 Për listën e mallrave / materialeve të përcaktuara në preventivin objekt prokurimi

**- Materiale elektrike (kabell, kabell TU (URAT) , ELEKTRODA Tokëzimi, Mufte TM, Panele TU, CELA),koka kablli 1 fazore , kabell xlpe gershet, terminal per kabell TU, MORSETE universale per fiksime tokezimi, shkeputes tokezimi shirit-litar, pajisje instalimi,**

**- Hekur shirit i galvanizuar**

**- Shkeputes tokezimi shirit-litar**

**- Transformator Fuqie,**

**- Gjenerator nga 600 kv deri ne 650 kv**

OE duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori ose marrëveshje bashkëpunimi me prodhuesin / distributor i autorizuar ose vetdeklarim nga OE, certifikate ISO 9001:2015 e prodhuesit/distributorit të autorizuar, dëshminë e orgjinalitetit , dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike e me standarte e kërkuara me keto specifika, katalogjet teknike apo pjesë të tyre.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**



Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

**Ju lutemi sigurohuni që:**

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.
- Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.
- Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak edhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.
- Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

- *Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.*
- *Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.*